Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 532/13
Datë 24.05.2013

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 1/2011- Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4,7,10 dhe 16, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 24.05.2013 nxjerr këtë:

VENDIM

1. Për akreditimin e QPAP "Oxfrod Studio" me 11 (njëmbëdhjetë) degë brenda Kosovës, 4 (katër) degë në Prishtinë, 2 (dy) degë në Gjilan, 2 (dy) degë në Prizren, 1 (një) degë në Klinë, 1(një) degë në Istog dhe 1 (një) degë në Gurrakoc, për periudhën: 24.05.2013 - 24.05.2016 për të ofruar kurse të gjuhës angleze:

1.1 Akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Nxënësve dhe stafit në të gjitha degët duhet të ju bëhet e ditur procedura mbi evakuimin në rast të zjarrit. Po ashtu, në daljet e të gjitha degëve duhet të vendoset shenja 'Dalje'.
- Certifikata e përfundimit të nivelit duhet t'i përshtatet Kornizës së Përbashkët Evropiane të Referencave (KPER) si dhe të jap një përshkrim të shkurtër të nivelit të cekur në certifikate.
- Rishikoj sistemin e vlerësimit të testit përfundimtar me gojë ashtu që rezultatet të jenë më të përafërta me përshkrimet në KPER.

- Të siguroj dëshmi të politikes mbi zhvillimin profesional të shkathtësive të mësimdhënies i cili mbështetet në udhërrëfyesin e AKK-se si dhe të sistemeve efektive për implementimin e kësaj politike.

1.2. Afati i plotësimit i të gjitha kushteve është deri me 30.08.2013.

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit, me datë: 24.05.2013, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

-Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
-Raporti i Vetë-vlerësimit;
-Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1. Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

2.2. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

3. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

4. Vendimi u dërgohet:

- QPAP "Oxfrod Studio"
- AKK-së.

Kryetari i KD së AKK-së
Ragip Gjoshi